



Data: 11/09/2020 Ref.: 1576/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Ri/akreditohen programet e studimit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
 - Kontabilitet (BSc), 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik
 - Banka dhe Financa (BSc), 180 ECTS, maksimumi 300 studentë për vit akademik
 - Banka dhe Financa (MSc), 120 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik
 - Ekonomiks (BSc), 180 ECTS, maksimumi 200 student për vit akademik
 - Ekonomiks (MSc), 120 ECTS, maksimumi 80 student për vit akademik
 - Menaxhment (BSc), 180 ECTS, maksimumi 350 student për vit akademik
 - Menaxhment (MSc), 120 ECTS, maksimumi 120 student për vit akademik
 - Marketing (BSc), 180 ECTS, maksimumi 200 student për vit akademik
 - Marketing (MSc), 120 ECTS, maksimumi 80 student për vit akademik
- II. Akreditohet programi i studimit i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
 - Paraja, Banka, Financa dhe Sigurime (MSc), 120 ECTS, maksimumi 30 student për vit akademik
- III. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 31 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për ri/akreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv I dhe II të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizita të ndara në distancë të akreditimit me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit: Kontabilitet BSc; Banka dhe Financa (BSc); Banka dhe Financa (MSc); Ekonomiks (BSc); Ekonomiks (MSc); Menaxhment (BSc); Menaxhment (MSc); Marketing (BSc); Marketing (MSc) dhe Paraja, Bankat, Financat dhe Sigurimet (MSc).

Vizita e parë në distancë është realizuar me datë 02.06.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Dorota Dobija, Christoph Back dhe Tornike Khoshtaria. Vizita e dytë në distancë është realizuar me datë 26.06.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Ramona Rupeika Apoga, Dietmar Paier, Christopher Bohlens dhe Nataliya Shiraz. Ndërsa vizita e tretë në distancë është realizuar me datë 02.07.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena lordache Platis.

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, programet e studimit të përmendura në dispozitivin I dhe II të këtij vendimi përmbushin substancialisht standardet e akreditimit të përcaktuara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar ri/akreditimin e tyre. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik;
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë